



Komuna e Vitisë
Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë

T H I R R J E P U B L I K E

Ditëve të fundit janë shtuar rastet e zjarreve të cilat po përhapen në fusha e pyje. Institucionet komunale të Vitisë, gjegjësisht, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë (DSHPE) apelon të qytetarët e komunës së Vitisë, që të shtojnë kujdesin në aspektin e sigurisë dhe mbrojtjen nga zjarri. Mos të ndizen zjarre në ambiente të hapura me qëllim të pastrimit të mbeturinave ngase shpesh dalin nga kontrolli dhe shkaktojnë rrezik për jetën e njerëzve dhe pasurisë.

Ju bëjmë me dije se zjarre vënia sanksionohet me ligj.

Nëse jemi sy çel dhe vigjilent me veprimet e tona do të jemi kontribuues të mëdhenj në zvogëlimin e rasteve dhe parandalimin e rreziqeve nga zjarri, andaj qytetarë të komunës së Vitisë kontribuoni në parandalimin e këtyre dukurive negative.

Të nderuar qytetarë ju lutëm lajmëroni rastet e zjarreve në këta numra pa pagesë :

112 (Qendra e Alarmit)

193 (Shërbimi për Zjarre fikje dhe Shpëtim)